

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 145/10, 136/11, 41. /2014, 53/ 16 dhe 83/18), dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim të parashtruar nga **Linamar Korporejshn**, me seli në 287 Spidvejl Avenju Vest, Guelf, Ontario, Kanada, përmes avokatit Zlatko Kujunxhiski, nga Shkupi, në seancën e mbajtur më datë **14.07.2023**, solli

AKTVENDIM

Vërtetohet se përqendrimi me të cilin **Linamar Korporejshn**, me seli në 287 Spidvejl Avenju Vest, Guelf, Ontario, Kanada, **synon të fitoj kontrollin** mbi **Dura Automotive Strekçers SHPKNJP Ilinden**, me adresë në TIRZ BUNARXHIK nr.2/11 Bunarxhik, Ilinden, Republika e Maqedonisë së Veriut, të biznesit, gjegjësisht një pjesë e organizuar e veprimtarisë së **DURA Automotive CZ, k.s.**, me një adresa të biznesit në Regrova 495, 388 01 Blatna, Çeki dhe **Dus Operating Inc.**, me adresë në 1780 Pond Ran, Obrn Hills, MI, 48326-2752, ShBA., edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

Parashtruesi i njoftimit të përqendrimit obligohet të paguajë taksë administrative për njoftimin e përqendrimit në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifor 34 të Ligjit për taksë administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje me nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës më 13.06.2023, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejme: Komisioni), është dorëzuar njoftim për përqendrim nga **Linamar Korporejshn**, me seli në 287 Spidvejl Avenju Vest, Guelf, Ontario, Kanada, me të cilën Linamar Korporejshn **synon të fitoj kontrollin** mbi **Dura Automotive Strekçers SHPKNJP Ilinden**, me adresë në TIRZ BUNARXHIK nr.2/11 Bunarxhik,

Ilinden, Republika e Maqedonisë së Veriut, të biznesit, gjegjësisht një pjesë e organizuar e veprimtarisë së **DURA Automotive CZ, k.s.**, me një adresë të biznesit në Regrova 495, 388 01 Blatna, Çeki dhe **Dus Operating Inc.**, me adresë në 1780 Pond Ran, Obrn Hills, MI, 48326-2752, SHBA.

Komisioni filloi me shqyrtimin e Njoftimit në ditën e pranimit të tij dhe në bazë të të dhënave të dorëzuara në Njoftimin e Përqendrimit, shtesave dhe bashkëngjitjeve në të, përcaktoi si më poshtë:

Aktivitetet themelore të biznesit të ndërmarrjeve të përfshira:

Linamar Korporejshn është një furnizues kanadez i automobilave me seli në Guelf, Ontario, Kanada, i cili kuoton në Bursën e Torontos (Toronto Stock Exchange). Linamar, së bashku me firmat –bijë të tij, prodhon produkte inxhinierike në Kanada, Evropë, Azinë Paqësore dhe pjesën tjetër të Amerikës së Veriut. Linamar përbëhet nga dy segmente operative - segmenti industrial dhe segmenti i lëvizshmërisë, të dyja globalisht aktive në zgjidhjet e prodhimit për produkte me inxhinieri të lartë.

Fusha kryesore e punës së **Dura Automotive Strekçers SHPKNJP Ilinden** konsiston në zhvillimin, prodhimin, furnizimin, shpërndarjen, tregtimin dhe shitjen sistemeve të kutive të baterive (battery enclosure systems) për automjetet elektrike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në tabakatë e baterive të lehta (lightweight battery trays), kuti baterish modulare (modular battery enclosures) dhe kuti baterish me shumë materiale (multi-material battery enclosures). Dura Automotive Strekçers SHPKNJP Ilinden zotëron një objekt prodhimi në Republikën e Maqedonisë së Veriut.

DURA Automotive CZ, k.s është e përfshirë në zhvillimin, prodhimin, furnizimin, shpërndarjen, marketingun dhe shitjen e sistemeve të kutive të baterive për automjetet elektrike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kushinetë e baterive të lehta , kuti baterish modulare dhe kuti baterish me shumë materiale. DURA Automotive CZ, k.s zotëron një objekt prodhimi në Republikën Çeke.

Aktivitetet e biznesit të Dus Operating Inc. janë të përqendruara në zhvillimin, prodhimin, furnizimin, shpërndarjen, marketingun dhe shitjen e sistemeve të baterive për automjetet elektrike, duke përfshirë, por pa u kufizuar në kushinetë e baterive të lehta, kuti baterish modulare dhe kuti baterish me shumë materiale. Duce Operating Inc. zotëron një objekt prodhimi në Alabama, SHBA.

Operacioni i synuar (shoqëria **Dura Automotive Strekçers SHPKNJP Ilinden** dhe pjesë/mjete të organizuara të ndërmarrjeve nga objektet e prodhimit në Masl Shoals, Alabama (SHBA) (aktualisht në pronësi të **Dus Operating Inc**) dhe Strakonice (Republika Çeke) (aktualisht në pronësi të **DURA Automotive CZ, k.s**) i përket një grupi kapitalesh që kontrollohet përfundimisht nga MidlGraund Menaxhment, LP.(MiddleGround Management, L.P.), me zyrën e saj të regjistruar në SHBA, e cila është një kompani prodhuese e specializuar në prodhimin e kutive të baterive për automjetet elektrike.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски